



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për Lotin I: "Shërbim gjelbërimi për Spitalin Universitar te Traumës" me fond limit 7,159,944 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH, me numër reference të Lotit I: REF-64023-04-19-2018

Drejtuar:

Operatorit ekonomik: "**KAJMAKU**" SHPK me NIPT K83725201G, adresa: Lagja Kastrioti, Pallati 16, Shk.2, kati 1, Ap. 9, Fushe Krujë.

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur, me objekt; "**Shërbim gjelbërimi**" ndarë në 2 (dy) lote.

Loti I: "Shërbim gjelbërimi për Spitalin Universitar te Traumës" me fond limit 7,159,944 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

Loti II: "Shërbim gjelbërimi për QSUT", me fond limit 5,080,585 (pesë milion e tetëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë

Numri i referencës së procedurës: **REF-64020-04-19-2018**

Numri referencës të Lotit I: **REF-64023-04-19-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Shërbim gjelbërimi" ndarë në 2 (dy) lote, me fond limit total 12.240.529 (dymbëdhjetë milion e dyqind e dyzetë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) Lekë pa TVSH

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [23 Prill 2018] [Numri 16]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

Për Lotin I: "Shërbim gjelbërimi për Spitalin Universitar te Traumës" me fond limit 7,159,944 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH:

1) **KAJMAKU SHPK**

K83725201G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **6.103.944** (gjashtë milion e njëqind e tremijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

2) **SORI-AL SHPK**

K31510059D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 7.013.020,⁸⁰ (shtatë milion e trembëdhjetëmijë e njëzetë presje tetëdhjetë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

3) ADEM POJANI PF

K51524013W

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **0** (zero) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

Janë s kualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Arsyet e s 'kualifikimit të ofertuesit ADEM POJANI P.F.

“Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për kualifikim sipas DST.”

2. Arsyet e s 'kualifikimit të ofertuesit SORI-AL shpk

“Nuk arriti të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001:2007 sipas konformitetit me standartet europiane, sepse certifikata e paraqitur N.22486 nuk përmban si aktivitet “kujdesin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra” apo aktivitet të ngjashëm me të. Certifikata e paraqitur nga ana e ofertuesit përmban si fushë aktiviteti: “Përgatitja, shërbimi dhe dhënia e vakteve; Shërbime pastrimi dhe saniteti”. Sqarojmë se në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018 si dhe nenit 30 VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se çdo certifikatë duhet të jetë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit. Prandaj ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në germën “c” të seksionit 2.4 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Veçanta për Kualifikim të DST.”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“KAJMAKU” SHPK me NIPT K83725201G**, adresa: Lagja Kastrioti, Pallati 16, Shk.2, kati 1, Ap. 9, Fushe Krujë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6.103.944 (gjashtë milion e njëqind e tremijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë (pa TVSH), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Spitalit Universitar të Traumë**, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, menjëherë nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.06.2018

Ankesa: PO

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS
DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

